

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TE UJËSJELLËS KANALIZIME

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve, për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe” me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë nga data fillimi i projektit deri me datë 31.08.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 167, datë 28.12.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr. 1 54/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 803/8, datë 28.12.2015, dërguar z. Ardian Allushi në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve, me shkresën nr. 803/9, datë 29.12.2015, dërguar Ministrin të Transportit dhe Infrastrukturës z. Edmond Haxhinasto dhe me shkresën nr. 803/10, datë 29.12.2015, dërguar Ministrin të Financave z. Shkëlqim Cani, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

-Projekti “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, është projekti i cili financohet nga Qeveria Japoneze dhe marrëveshja financiare është ratifikuar me ligjin nr. 9964, datë 24.07.2008 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë për financimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”.

Në marrëveshjen financiare, institucionet dhe strukturat të cilat janë ngarkuar për implementimin e projektit janë:

1. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, sot Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, si “Agjencia ekzekutuese”, 2. Agjencia Operuese është Ndërmarrja e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, Tiranë, aktualisht Ujësjellës Kanalizimet SHA Tiranë.

-Nga auditimi u konstatua se rolin e Agjencisë Ekzekutuese e luan Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë. Për këtë ndryshim të marrëveshjes financiare nuk ka asnjë miratim nga palët nënshkruese të Marrëveshjes. Gjithashtu, edhe pas kërkesave të shumta të grupit të auditimit, nuk na u paraqit asnjë dokument, shkresë apo urdhër ku të përcaktohet se DPUK do të jete agjencia ekzekutuese, pse është bërë ky ndryshim dhe kush janë argumentet dhe arsyet e tij (ndryshimit).

- Mungon një urdhërese apo dokument që të përcaktojë detyrimet që duhet të përmbush DPUK për implementimin e projektit. Nga komunikimi me stafin e DPUK i cili është marrë në vite me ndjekjen e projektit, si dhe nga koordinatori aktual i projektit nuk na u dha asnjë shpjegim i cili do të sqaronte ndryshimin e agjencisë ekzekutuese, pra kalimin për zbatimin e projektit nga Ministria të DPUK. Veprimet e më sipërme janë në kundërshtim të Marrëveshjes financiare të ratifikuar me ligjin nr. 9964, datë 24.07.2008.

- Në zbatim të rregullores të funksionimit të DPUK-së miratuar me vendim nr. 93, datë 28.07.2009 të ministrit të MPPTT (sot MTI), është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Projekteve të Huaja, e cila në përbërjen e saj ka koordinatore të ngarkuar të menaxhojnë, koordinojnë fondet e akorduara nga donatorët e ndryshme, konkretisht për gjashtë projekte, ndër të cilët një është edhe projekti Hidrik dhe Kanalizimet e Tiranës së Madhe.

-Nga auditimi u konstatua se për periudhë nga fillimi i projektit viti 2008 deri në momentin e auditimit, ka pas ndryshime dhe lëvizje të shpeshta të koordinatoreve të ngarkuar për ndjekjen e projektit Hidrik dhe Kanalizimeve të Tiranës së Madhe, fenomen ky i cili ka sjellë

vështirësi në menaxhimin e projektit, në ndjekjen dhe zbatimin e tij, në mbajtjen, grumbullimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të projektit. Më kryesorja është se ndryshimi i shpeshtë i stafit që merret me ndjekjen e projektit ka sjell vonesa në zbatimin e tij. Situata e cila ka shoqëruar ndryshimin e koordinatorëve të projektit, u reflektua edhe gjatë periudhës së auditimit, ku u hasën vështirësi në grumbullimin dhe vënien me shumë vonës në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm. Në shumë raste ky dokumentacion ka qenë i mangët dhe është plotësuar pas kërkesave të shumta të grupit të auditimit.

Për sa më lart rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve dhe nga PIU Hidrik, të merren masa për të mbledhur dokumentacionin e plotë të projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimit për Tiranën e madhe”, për arsye se shumë dokumente të këtij projekti janë në Ministrinë e Transportit dhe Industrisë dhe të arkivohen pranë PIU/DPUK.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi u konstatua se koordinatori aktual i projektit, i emëruar me shkresën nr. 1605, datë 01.06.2015, në momentin e emërimit, nuk ka marr në dorëzim nga paraardhësi dokumentacionin e projektit, veprim ky në kundërshtim me pikë 13, të udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu, nga koordinatori nuk është bërë një organizim i punës, nuk janë realizuar mbledhje mujore me supervizorin për të analizuar ecurinë e punimeve, nuk është hartuar dhe paraqitur planin e investimeve sipas financimit të parashikuar në Marrëveshjen financiare, si dhe nuk ka relacione në lidhje me ecurinë e projektit. Këto veprime janë në kundërshtim me pikë 4.10 të rregullores së funksionimit të DPUK-së.

Për sa më lart rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve dhe PIU të merren masa që në të ardhmen, për çdo lëvizje të koordinatorëve të projektit të kryhen veprimet e dorëzimit të detyrës, në përmbushje të udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në vazhdimësi

3.Gjetje nga auditimi:

-Agjencia Operuese, e cila sipas marrëveshjes Financiare është Ujësjellës Kanalizimet SHA Tiranë, u konstatua se nuk ka luajtur asnjë rol në ecurinë e deritanishme të projektit. Ujësjellës Kanalizimet SHA Tiranë është përfituesi fundore i investimit. Ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ujësjellës Kanalizimeve SHA Tiranë, me date 12.02.2009, është lidhur një marrëveshje nën-huaje, në të cilën janë përcaktuar kushte dhe detyrimet që duhet të përmbush UK SHA Tiranë, në lidhje me shlyerjen e huasë, principalin, interesin dhe tarifën e detyrimit financiar.

-Në nenin IV, “Zbatimi i projektit”, të marrëveshjes së nën-huasë, është përcaktuar se UKT SHA do të realizojë projektin me kujdesin dhe efikasitetin e nevojshëm dhe në përputhje me praktikën e përshtatshme administrative, financiare dhe teknike. Për këtë arsye, UKT merr përsipër të sigurojë sa më shpejt që të jetë e nevojshme fondet, ambientet, shërbimet dhe burimet e tjera që kërkohen nga projekti gjatë zbatimit të tij.

-Nga sa më lart rezulton se si në Marrëveshjen financiare ashtu edhe në marrëveshjen e nën-huasë, është UKT Sha, e cila është ngarkuar si Agjenci Operuese e Projektit. Në fakt nga auditimi rezulton se UKT SHA nuk ka zbatuar dhe nuk është përfshirë në zbatimin e

projektit, por bën vetëm shlyerjen e detyrimeve financiare që lindin nga marrëveshja financiare dhe ajo e nën-huasë. Për këtë ndryshim të kushteve të marrëveshjeve, nuk është dhënë asnjë shpjegim si dhe nuk ekziston një korrespondencë ku të faktohet ndryshimi dhe kalimi për zbatim i projektit të DPUK, veprime këto në kundërshtim me Marrëveshjen financiare të ratifikuar me ligjin nr. 9964, datë 24.07.2008.

-Nga nga pala shqiptare Marrëveshjen Financiare të ratifikuar më ligjin nr. 9964, datë 24.07.2008, nuk janë përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja financiare, për krijimin e strukturave dhe ngarkimin e institucioneve, të cilët do të jenë përgjegjës dhe garant për implementimin e projektit.

-Agjencia ekzekutuese duhet ti dorëzoj Bankës raporte ecurie për projektin çdo tre muaj (në mars, qershor, shtator dhe dhjetor të çdo viti) derisa të përfundojë projekti, në formë dhe detaje të tilla siç mund të kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme. Nga DPUK si agjenci ekzekutuese nuk janë hartuar dhe as dorëzuar te Banka raporte mbi ecurinë e projektit, Banka merr raportime vetëm nga Konsulenti.

Për sa më lart rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve në cilësinë e Agjencisë së Zbatimit të Projektit, të merren masa që të dorëzoj te Banka raporte mbi ecurinë e projektit çdo tre muaj, deri në përfundimin e projektit, detyrim ky i cili i lind nga Marrëveshja Financiare, detyrimi që nga auditimi rezultoi i pa përmbushur.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi:

-Në seksionin 3 të Marrëveshjes financiare është përcaktuar se përfundimi i projektit ka qenë përcaktuar fundi i vitit 2014. Në fakt nga auditimi u konstatua se projekti ende nuk ka përfunduar. Në fillim të vitit 2014 është nënshkruar kontrata për fillimin e punimeve, ndërsa punimet kanë fillua në qershor të vitit 2014 dhe priten të përfundojnë pas 30 muajve ose në fund të vitit 2016.

-Nga auditimi u konstatua se nga palët kanë rënë dakord dhe kanë përcaktuar një afat tjetër për përfundimin e projektit, i cili do të jetë 24.10.2019, me shtyrje prej 5 viteve. Pra rezulton se projekti nuk ka mundur ende të përmbush objektivin kryesor, situatë kjo që dëshmon se sistemi i kanalizimeve vazhdon të jetë i amortizuar, jo eficient, dhe nuk janë eliminuar ndotjet që vijnë nga derdhja e ujërave në lumenjtë e Tiranës.

Për sa më lart rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve dhe PIU Hidrik të merren masa me qëllim përfundimin dhe realizimin e projektit brenda afatit të ri të përcaktuar nga palët, për arsye se projekti nuk ka mundur të realizohet brenda afatit fillestar të përcaktuar në Marrëveshjen financiare dhe si pasojë gjendja e sistemit të kanalizimeve vazhdon të jetë e rënduar dhe e amortizuar.

Në vazhdimësi

5.Gjetje nga auditimi:

- Me shkresën nr. 10845/3 datë 1.09.2015 të Ministrit të Financave, drejtuar Bankës Japoneze është kërkuar shtyrja e afatit të disbursimeve si dhe rialokimi i fondit të kontigjencës, i cili është kërkuar të kalojë për zërin “Shërbime konsulente”. Arsyeja e shtyrjes së afatit dhe rialokimit ka të bëjë me vonesën që është shoqëruar procedura e prokurimit për punimet e ndërtimit dhe mallrave. Me notën verbale të ambasadës japoneze datë 20.0.2015, është miratuar shtyrja e afatit të disbursimeve me 48 muaj/4 vjet, deri në 24.10.2019, si dhe kalimi i shumës së kontigjencës për zërin e shërbimeve të konsulencës. Pas rialokimit, rezulton se zëri

i konsulencës është rritur në shumë 465 milionë jenë japonezë, shumë e cila ka rritur koston e kontratës së konsulentit dhe të projektit në tërësi.

-Nga auditimi konstatohet se çdo etapë e projektit është shoqëruar me vonesa krahasuar me skedulën e miratuar të implementimit të projektit. Gjithashtu, tenderi i kontratës së ndërtimit ka zgjatur 18 muaj më shumë se koha e parashikuar.

-Përzgjedhja e konsulentit ka zgjatur më shumë 7.5 muaj më shumë se skeduli i parashikuar. Zgjatja në procesin e projektimit ka qenë 20 muaj sepse territori që është përdorur për të ndërtuar impiantit të trajtimit (STP) nuk ishte i njëjti me atë të caktuar në fillim të dizajnit. STP është ndryshuar në pozicionin e ri gjeografik, sepse statusi i vendit të ri ishte një tokë bujqësore. Kështu që buxheti i shtetit duhej të përballohet me koston e shpronësimit të tokës bujqësore dhe të rishikohet për miratim nga autoritetet përkatëse të qeverisë. Procesi i miratimit mori kohë më të gjatë se sa që parashikuar.

Për sa më sipër rekomandojmë

- Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve, të marri masa që për realizimin e komponentëve të projekteve dhe investimeve me financime të huaja (punime ndërtimi, blerje mallrash, shërbimesh dhe konsulenca), procedurat e tenderimit të kryhen brenda afateve të përcaktuara në manualët e donatorëve, me qëllim të mos zvarritjes së procedurave dhe mos rritjes së kostos së kontratave.

Në vazhdimësi

6.Gjetje nga auditimi:

-Procesi i plotësimit dhe saktësimit të pasurive që u planifikuan për shpronësim ka vazhduar deri në maj të vitit 2013. Në qershor të vitit 2013 është lidhur akt marrëveshja midis MEI dhe DPUK për pranimin e kërkesës së kësaj të fundit për shpalljen për shpronësim publik të 155 pasurive të cilat do të prekeshin nga ndërtimi i ITUZ. Në shkurt me VKM nr. 61, datë 12.02.2014 u realizua shpronësimi i 55 pasurive nga 155 të planifikuara. Me shpalljen e tij pranë DPUK si autoriteti që do të ndjek zbatimin e këtij vendimi u depozituan ankesa nga pronarë të ndryshëm, përgjithësisht për mospranimin e masës së dëmshpërblimit. Në shtator me VKM nr. 772, datë 16.09.2015 u realizuar shpronësimi i 9 pasurive të tjera.

Deri më sot nuk është realizuar asnjë pagesë për efekt shpronësimi megjithëse fondi i planifikuar është aktiv.

Për sa më lart rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve të marri masa, për të kryer sa më shpejt pagesat për pronarët e shpronësuar, me qëllim që ky proces mos të bëhet pengesë në zbatimin dhe realizimin e projektit.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi u konstatua se pagesat për punimet e ndërtimit nuk janë vërtetuar nga kryeinxhinieri ose Oficeri i projektit, për arsye se DPUK për projektin, pranë Drejtorisë së Projekteve të Huaja, për projektin Hidrik dhe kanalizimin e Tiranës së Madhe, nuk ka rekrutuar një të tillë, veprim ky në kundërshtim me Marrëveshjen financiare. Vërtetimi për punimet e ndërtimit të parashikuar në Marrëveshjen financiare, nuk është kryer as nga koordinatoret e projektit, të cilët janë ngarkuar të menaxhojnë/koordinojnë fondet e projektit.

Për sa më lart rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve dhe PIU Hidrik të merren masa që pagesat për punimet e ndërtimit të vërtetohen edhe nga koordinatori i projektit (oficeri i

projektit), me qëllim që puna e kryer nga kontraktori të jetë e kënaqshme dhe në përputhje me kushtet e kontratës përkatëse, për arsye se nga auditimi u konstatua se nuk është kryer një vërtetim i tillë, vërtetim i cili duhet të bëhet në përputhje me marrëveshjen financiare, programi 6 “Proceduarat e rimbursimit”.

Në vazhdimësi

8.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi u konstatua se shuma gjithsej e huasë të disbursuar është 4,003 milionë jenë japonezë ose në masën 64% të huasë, ka mbetur pa u likuiduar shume 4,595 milionë, jenë japonezë ose në masën 36% e huasë. Nga të dhënat mbi realizimin dhe planifikimin e disbursimeve në vite, rezulton se shkalla e realizimit të disbursimeve ka qenë e ulët, larg planifikimit dhe parashikimit të bërë në Marrëveshjen financiare, kjo për arsye se projekti nuk ka arritur të implementohet brenda afatit të përcaktuar.

-Nga auditimi u konstatua se nuk është bërë një planifikim tjetër për disbursimin e huasë në vite, për arsye se projekti jo vetëm që nuk ka arritur të implementohet brenda afatit të përcaktuar, por gjatë kësaj kohe ka edhe rialokime të fondeve të huasë.

Për sa më lart rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve dhe PIU Hidrik të merren masa për hartimin e një planifikimi vjetor për disbursimet që do të kryhen në vazhdimësi për projektin, si dhe ti paraqitet Bankës për miratim, për arsye se planifikimi i përcaktuar në Marrëveshjen financiare nuk ka mundur të realizohet, si dhe nga rialokimi i fondeve të huasë ka ndryshim të shumave të komponentëve.

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi:

- Për realizimin e komponentit “Shërbimet e konsulencës”, më datë 19.10.2009, është lidhur kontrata me operatorin, me vlerë kontrate 1,030 milionë jenë japonezë dhe me afat realizimi 63 muaj ose më datë 20.01.2015. Kur afati i kontratës së konsulentit duhet të përfundonte në 3-mujorin e parë të vitit 2015, rezulton se afati i saj është shtyrë deri në fund të vitit 2016.

-Nga auditimi u konstatua se shuma e disbursimeve për këtë kontratë është në shumë 846 milionë jenë japonezë ose në masën 82.14% të kontratës. Nga analiza e shpenzimeve të realizuar për kontratën e konsulentit, rezulton se ka mbetur për realizim të plotë të saj shuma 245 milionë jenë japonezë ose 17.86 % e vlerës së kontratës, në një kohë që afati i kontratës është shtyrë deri në fund të vitit 2016, për arsye se afati i kontratës së konsulentit ecën paralelisht me afatin e kontratës së punimeve.

-Disbursimet për kontratë e konsulentit, janë kryer kryesisht për punën që konsulenti ka bërë gjatë procesit të tenderimit, për arsye se procedura e tenderimit për kontratën e punimeve të ndërtimit ka zgjatur për një periudhë 3 vjeçare. Vonesat në procesin e tenderimit, kanë ardhur kryesisht gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. KVO e ka përcjell disa herë raportin e vlerësimit të ofertave te Banka, deri në miratimin përfundimtar. Konsulenti gjatë procesit të tej zgjatura të tenderimit, është paguar rregullisht.

-Duke qenë para këtij fakti, rezulton se shuma e mbetur e pa disbursuar e kontratës së konsulentit, jo vetëm që nuk është e mjaftueshme për realizimin e plotë të saj, por do të kërkojë një shtesë kontrate. Nga auditimi u konstatua se kontrata e konsulentit nga rialokimi i fondeve të huasë është rritur në shumën 465 milionë jenë japonezë dhe vlera totale e saj ka kapur shumë 1,495 milion jenë japonezë, shumë e cila rezulton se është më e lart se fondi

limit i përcaktuar në marrëveshjen Financiare për vlerën 404 milionë jenë japonezë, shumë e cila rëndo koston e projektit.

Nga ecuria e projektit, nga ndryshimi i kontratës së punimeve, shtyrja e afatit të përfundimit të projektit, rezulton se shtesa e kontratës së konsulentit nuk do të jetë e mjaftueshme dhe do të lind nevoja e financimit shtesë për realizimin e saj. Çdo shtesë tjetër e kontratës për shërbimin e konsulentit do të sjellë rritje të koston së projekti dhe do të shkaktoj efekt negativ financiar në buxhetin e projektit.

- Nga auditimi i pagesave të kryera për konsulentit, u konstatua se nga lidhja e kontratës deri në momentin e auditimit janë kryer gjithsej 64 pagesa. Për secilën pagesë është bërë një kërkesë për disbursim nga kompania e kontraktuar. Në fakt, jo në të gjitha rastet konsulentit i është paguar shuma e kërkuar, por i është disbursuar më pak, ku i janë zbritur shpenzimet të cilat nuk janë në përputhje dhe që nuk njihen si shpenzime të ribursueshme. Në dokumentet bashkëlidhur pagesave dhe kërkesave për disbursim, nuk është përcaktuar se cilat zëra të faturës nuk janë njohur si shpenzime të ribursueshme, mungojnë bashkëlidhur faturave të paraqitura nga konsulenti dokumentet justifikuese për këto shpenzime. Këto dokumente i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit pas konstatimit të bërë dhe janë dokumente të cilat i disponon konsulenti, në një kohë që duhej të ishte një kopje e tyre edhe në setin që disponon DPUK.

Për sa më lart rekomandojmë:

Agjencia e Zbatimit të projektit (DPUK) dhe PIU Hidrik të marr masa që në vazhdimësi, të bashkëlidh në pagesat që i disbursohen konsulentit, të gjithë dokumentacionin financiar justifikues, ku të pasqyrohen edhe zërat e shpenzimeve të cilat nuk i ribursohen konsulentit.

Në vazhdimësi

10.Gjetje nga auditimi:

-Gjithashtu, u konstatua se për çdo pagesë disbursimi për konsulentin, është paguar edhe TVSh nga ana e Agjencisë Ekzekutive (DPUK), TVSh e cila është llogaritur dhe paguar mbi të gjithë shumë e kërkuar nga konsulenti për disbursim, në një kohë që vetë shuma e disbursimit është më e vogël. Nga llogaritja në total vlera e TVSh të paguar për shpenzime të cilat nuk janë ribursuar në çdo faturë, po janë ribursuar në faturat pasardhëse.

Për sa më lart rekomandojmë:

Agjencia e Zbatimit të projektit (DPUK) dhe PIU Hidrik të marr masa që gjatë kryerjes së pagesës së TVSh, për shpenzimet e konsulentit, të likuidoj shumën që përkon me shpenzimin aktual të ribursuar dhe jo të bëjë shpërndarjen e pagesës së TVSh në muajt në vijim.

Menjëherë

11.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i dokumenteve financiare justifikuese që shoqërojnë situacionet mujore të konsulentit konstatohet se në disa raste është kryer pagesa e disa zërave të përfshirë në situacion të cilat janë kryer pas datës së situacionit të cilat nuk përbëjnë shpenzim aktual të konsulentit

-Në situacionin e muajit maj 2010 në zërin shpenzime mirëmbajtje zyre janë përfshirë blerje e pajisjeve të zyrave dhe swicher edhe në zërin shpenzime telefonike kombëtare është përfshirë instalimi i një qendre telefonike të brendshme, pagesa e të cilave ishte ndarë në disa situacione.

-Në disa raste për pagesat e konsulentit u konstatua se janë rimbursuar shpenzime, për të cilat shërbimi është kryer për periudha paraardhëse, ndërsa fatura për këto shërbime daton në një kohë të dytë. Veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Gjithashtu për pagesat e konsulentit u konstatua se ka copëzim të rimbursimit të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe komunikimit. Për një shpenzim të faturuar, rimbursimi nuk është bërë i plotë por është ndarë në pagesat e rimbursimit të muajve në vijim. Për këto shpenzime nuk është tejkaluar zëri i planifikuar sipas kontratës.

Për sa më lart rekomandojmë:

Agjencia e Zbatimit të projektit (DPUK) dhe PIU Hidrik të marri masa që të pranojë dhe të kryej pagesat për disbursimin e konsulentit për shpenzimet aktuale, në përputhje me përcaktimin e bërë në kontratën përkatëse dhe jo të bëjë ndarjen e pagesave në disa situacione.

Menjëherë

12.Gjetje nga auditimi:

-Në tenderin e zhvilluar për zbatimin e projektit “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve për Tiranën e Madhe” dosja e prokurimit nuk është e plotë me dokumentacion dhe nuk është e inventarizuar në kundërshtim me ligjin nr. 9154, date 06.11.2003 “Për arkivat”. Ka mangësi në raportet e njëpasnjëshme të njësive të prokurimit të ngritura, si dhe zgjatje të afateve të proceseve për kryerjen e prokurimit.

-Urdhri i prokurimit mbi zhvillimin e procedurës së tenderit nuk u vu në dispozicion grupit të auditimit.

-Zhvillimi i Tenderit të ndërtimit për projektin “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve për Tiranën e Madhe”, është shtrirë në një periudhën kohore që prej 6 korrik 2011 me publikimin në shtyp të ftesa për ofertë, dhe ka përfunduar me lidhjen e kontratës më 31 Janar 2014. Në këtë periudhë të gjatë kohore janë ndryshuar shumë KVO të cilat kanë paraqitur raportet e tyre përkatëse.

-Për tenderin e zhvilluar me objekt mbi Shërbimin të Konsulencës për projektin “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve për Tiranën e Madhe”, u konstatua se dosja e kësaj procedure nuk ishte e arkivuar apo marrë në dorëzim nga DPUK. Drejtorja e Projekteve të Huaja, sipas koordinatorit të projekt kjo dosje është në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës. Edhe pas kërkesave të shumta të grupit të auditimit, kjo dosje me dokumentacionin e plotë nuk na u vu në dispozicion, veprime këto në kundërshtim me ligjin e Marrëveshjes nr. 9964, datë 24.7.2008. Nga Njësia e zbatimit të projektit nuk na u vunë në dispozicion dokumentet dhe procedura e plote e këtij tenderi.

-Në të gjithë urdhrat për ngritjen e KVO, nuk është përcaktuar lloji i procedurës së tenderit dhe nuk është cituar fondi limit për tenderin që do zhvillohet duke u mjaftuar me planin financiar në total, sipas përcaktimeve në marrëveshjen financiare.

Për sa më lart rekomandojmë:

Agjencia e Zbatimit të projektit (DPUK) dhe PIU Hidrik të marri masa të menjëhershme për plotësimin me dokumentacionin e plotë të dosjeve të prokurimit, për dy procedurat e zhvilluara për projektin. Gjithashtu, të merren masa për arkivimin e këtyre procedurave në përputhje me ligjin nr. 9154, date 06.11.2003 “Për arkivat”.

Menjëherë

13.Gjetje nga auditimi:

-Për realizimin e komponentit “Punimet civile dhe prokurimi i mallrave”, ndërmjet DPUK si njësi operuese e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe bashkimit të operatorëve ekonomiksh.p.k, është nënshkruar kontrata datë 30.01.2014. Vlera e kontratës së

punimeve është 8,168,997,959 jenë japonezë. Afati i përfundimit është përcaktuar 30 muaj nga data e fillimit të punimeve. Mbas procedurave të tenderimit që kanë zgjatur rreth 2 vite, më datë 07.11.2013, JICA ka dhënë "NO OBJECTION" për kontraktorin fitues.

-Pas përzgjedhjes së operatorit fitues të dalë nga tenderi dhe pa u lidhur kontrata, janë konstatuar ndryshime nga oferta fillestare si rezultat i negociatave midis DPUK dhe kontraktorit, si më poshtë:

Me shkresën nr. 2601 prot datë 11.11.2013 drejtuar sh.p.k meCorporation, nga Drejtori i Përgjithshëm i DPUK, është kërkuar ftesë për negociim mbi kontratën, ku paraqiten pikat kryesore mbi negociatën dhe në pikën nr. 3 të kësaj shkrese paraqiten dhe faktorët (indekset) për rregullimin e çmimit.

-Me shkresën nr. 2794 prot., DPUK datë 02.12.2013 kthehet përgjigje nga operatori ekonomik sh.p.k, ku kërkon sqarimi në lidhje me pikën 3, të ftesës për negociim, dhe shprehet se këto faktorë janë paraqitur në ofertën e tij të rregullimit të të dhënave.

-Me shkresë nr. 2797 prot. datë 02.12.2013 nga DPUK i kërkohet kontraktorit të sqarohet origjina e referencës së disa indekseve.

-Me shkresën nr. 2357 datë 18.10.2013, bashkimi i operatorëve sh.p.k - Corporation ka ripërsëritur sigurinë me garanci bankare mbi vlefshmërinë e ofertës fituese (datë 5.11.2013) deri më datë 28.02.2014, në një kohë që pas ndryshimeve të miratuara nga palët, vlefshmëria e ofertës nuk është më efektive.

Duke u bazuar në manualin e prokurimit ODA-s, kërkesa për negociim duhej tu parashtrohej edhe operatorëve të tjerë ekonomik, për vetë faktin se ndryshimet janë bërë para fazës së lidhjes së kontratës.

Me bërjen efektive të të gjitha ndryshimeve të mësipërme, kontrata është lidhur më datë 30.01.2014. Këto ndryshime janë bërë para lidhjes së kontratës me ofertuesin ekonomik, duke sjell ndryshime të Dokumenteve Standarde të tenderit, si dhe ndryshim të strukturës së ofertës ekonomike të shpallur fituese.

Ndryshimet e parashtuara në minutat e takimit janë finalizuar në pjesë të kontratës, pikërisht në pjesën C të saj, që sollën ndryshime në kushtet e kontratës e cila është pjesë e DST dhe ndryshimin e kushteve financiare të saj.

-Më datë 28.04.2014 është nënshkruar amendim i kontratës, ku ndryshohen disa kushte të kontratës në lidhje me paradhënien. Në amendim është rënë dakord që paradhënia nga masa 20 % të bëhet 25 % dhe kthimi i saj (paradhënies) të bëhet nga 20 % në 41.6 %.

Vlera shtesë prej 5 % të paradhënies është 408,449,898 jenë japonezë dhe shuma totale e paradhënies 2,042,249,490 jenë japonezë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

a- Drejtorja e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve, të marr masa që për kontratat që do të nënshkruaj në të ardhmen, për realizimin e projekteve dhe investimeve me financime të huaja, të respektohen kushtet e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderimit dhe të manualeve të donatorëve përkatës.

Në vazhdimësi

b-Drejtorja e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve të marri masa që në të ardhmen për kontratat e tipit FIDIC, të respektojë kushtet mbi garancinë e kontratës, duke mos lejuar sigurimin në kompani sigurimi, por me garanci bankare, për arsyes se kontratat tip FIDIC kanë të përcaktuar se garancia e kontratës duhet të bëhet vetëm nëpërmjet vërtetimit bankar.

Në vazhdimësi

14.Gjetje nga auditimi:

-Në amendimin mbi paradhënien nuk ekzistojnë korrespondenca mbi rritjen e paradhënies prej 5%. Pra nuk kuptohet se për çfarë arsye duhej ky ndryshim, gjithashtu nuk ka një realacion argumentues nga ana e konsulentit.

-Më datë 09.01.2014 janë kryer minuta takimi midis DPUK konsulenti dhe operatorit ekonomik sh.p.k. Objekti i takimiti ka qenë negocimi mbi formulën e rregullimit të çmimit, ku operatori ekonomik propozon koeficiente të tjerë dhe indeksimin mbi kursin e këmbimit valutor për shkak të monedhave të ndryshme dhe efektin në kohë të parasë. Negocim ka lejuar ndryshimin me efekt rritje për disa koeficient dhe bërjen zero të koeficienteve ndaj disa elementëve të tjerë. Ndryshimet e kontratës së punimeve për periudhë nga 2012 në 2014, rrjedhimisht e rrisin vlerën e kontratës fillestare, duke sjell një kosto shtesë dhe rënduar buxhetin e projektit.

-Mbi këto ndryshime nuk është kryer asnjë analizë, studim apo shkresë përcjellëse informuese dhe konsultuese, drejtuar MF dhe MTI, nga DPUK. Gjithashtu, konsulenca duhej të krahasonte dhe të vlerësonte ndryshimet se çfarë efekti mund të sjellin për vazhdimësinë e projektit.

Në ofertën e kontraktorit në 04.09.2012 janë përcaktuar qartë zbritjet e tij, përqindjet e propozuara për çdo kosto në funksion të kohës dhe formula standarde e cila është pjesë dhe e dokumenteve standarde të tenderit bazuar në manualin Japonez "ODA". Kushtet dhe forma e kontratës ka qenë pjesë e tenderit në pjesën e tretë të volumit VI dhe pjesa e rregullimit për ndryshime të kostove është në pikën 13.8 tek të dhënat e përgjithshme të kontratës.

Të gjitha veprimet e mësipërme kanë marrë "NO OBJECTION" nga donatori, JICA.

-Shtesa C e kontratës është veprim i cili ka sjell ndryshim të strukturës së ofertës të shpallur fituese. Ndryshimet mbi formulën e ndryshimit të kostove, duke ndryshuar koeficientet dhe duke vendosur kurs këmbimi valutor në monedha të tjera, kanë sjellë një efekt negativ në rritje të fondit të punimeve rreth 40 %.

-Nga sa më lart rezulton se vlera e kontratës së punimeve në shumën 8,138,997,959 jenë japonezë, nuk do të jetë e mjaftueshme për përfundimin (realizimin) e plotë. Kështu që do të dalë nevoja e sigurimit të fondeve shtesë për punimet, pasi sipas marrëveshjes çdo shtesë mbi shumën e huasë, duhet të sigurohet nga pala shqiptare.

Pra i gjithë efekti financiar i ndryshimit të kontratës së punimeve do të rëndojë në buxhetin e shtetit, shumë e cila do të rëndohet edhe nga detyrimi i TVSH.

Ndryshimi i faktorëve tek formula dhe ndryshimet mbi kursin valutor vetëm për 9 situacionet e para të cilat janë likuiduar deri në fund të periudhës në objekt auditimi, ka sjell një kosto shtesë prej **2,390,368 Euro**. Deri në fund të projektit parashikohet mesatarisht një kosto shtesë në vlerë prej **21,993,729 Euro**.

Për sa më lart rekomandojmë:

a-Nga Agjencia e Zbatimit të projektit (DPUK) të merren masa që në të ardhmen projektet me financime të huaja, të realizohen brenda afateve të përcaktuar në marrëveshjet financiare, me qëllim që mos të ketë zvarritje të cilat çojnë në ndryshime të kushteve të kontratave dhe në kosto shtesë të financimit, për arsye se për projektin "Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe", vetëm nga mosrealizimi brenda afatit të përcaktuar të tij (projektit), kanë ndryshuar kushtet e kontratës, duke sjell një efekt negativ në shumën 2,390,368 euro vetëm për 9 situacionet e para dhe me një efekt financiar të pritshëm në shumën 21,993,729 euro.

Në vazhdimësi

b-Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve, të marr masa që në të ardhmen në punët civile, për projektet dhe investimet me financime të huaja, të mos ketë rinegocime nga

efektet në kohë të kostove të kontraktorit mbi këmbimin valutor të monedhave në formulën e rregullimit në kohë të çmimeve, duke sjellë efekte negative mbi Autoritetin Kontraktortë.

Në vazhdimësi

15.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi u konstatua se është disbursuar shuma 2,507 milionë jenë japonezë ose në masën 11% të vlerës të saj, ka mbetur për likuidim shuma 5,662 milionë jenë japonezë. Duke analizuar mënyrën se si janë bërë pagesat e disbursimeve, ku për çdo situacion kemi një rritje në masën 40% për arsye të indeksimit të formulës së axhustimit të çmimeve, do të rezultojë që deri në përfundim të kontratës do të duhet shtesë e vlerës së kontratës. Diferenca e fondit limit i përcaktuar për punimet civile dhe prokurimin e mallrave dhe vlerës së kontratës së lidhur është 1,069 milionë jenë japonezë, është shumë e pamjaftueshme për realizimin e gjithë kontratës, gjithashtu shuma e përcaktuar në marrëveshje për zërin e kontigjencës, është kaluar për kontratën e konsulentit.

-Nga ana e Agjencisë Ekzekutive nuk është bërë një analizë e hollësishme, me qëllim që të parashikohet se sa do të jetë shuma shtesë që do të duhet për të realizuar kontratën dhe për të përfunduar me sukses projektin. Kjo analizë duhet të jetë sa më e studiuar me qëllim që të parashikojë të gjitha kostot shtesë të projektit. Gjithashtu duhet që DPUK të kërkojë në rrugë zyrtare nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe nga Ministria e Financave, fonde shtesë për realizimin e projektit, në zbatim të Marrëveshjes financiare në të cilën përcaktohet se, pala shqiptare duhet të sigurojë çdo shtesë financimi mbi shumën e huasë së akorduar.

Për sa më lart rekomandojmë:

Nga Agjencia Ekzekutive e projektit (DPUK) dhe PIU Hidrik, të bëhet një analizë e hollësishme, me qëllim parashikimin e koston shtesë që do të duhet për realizimin me sukses të projektit, për arsye se nga ndryshimet që janë bërë në kontratën e punimeve, do të duhet një financim shtesë i konsiderueshëm.

Menjëherë

16.Gjetje nga auditimi:

-Deri në periudhën objekt auditimi janë certifikuar 9 situacione pjesore të bashkëlidhura me vizatimet Asbuild, bashkë me librezat e masave për çdo zë punimi. Pas verifikimeve të librezës së masave dhe matjeve të disa zërave të punimeve në terren konstatohet se është respektuar projekti deri në këtë fazë, por vizatimet për çdo situacion duhet të pasqyrohen të plota me të gjitha prerjet tërthore të seksioneve të hekurit etj, pasi vizatimet aktuale nuk e pasqyrojnë korrekt dhe me detaje sasinë (volumin) në situacionin.

Për sa më lart rekomandojmë:

Agjencia e Zbatimit të projektit (DPUK) dhe PIU Hidrik të marr masa të menjëhershme për plotësimin me dokumentacionin e plotë të dosjeve të punimeve që në çdo situacion pjesor të pasqyrohet:

- Ditari i punimeve në kantier,*
- Proces verbale të punimeve të maskuara,*
- Teste të ndryshme të betoneve, hekurit, pajisjeve etj.,*
- Foto të objektit gjatë punimeve në vazhdimësi,*
- Të mbahen korrespondenca të rregullta, të plota e të justifikuar me relacione përkatëse të ndryshimeve në vazhdimësi,*

- Të analizohen me ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë zëra të rinj të punimeve nëse do të ketë ndryshime në detajet e veprës,
- Të analizohet me kujdes të veçantë përdorimi i fondit rezervë.

B. TE TJERA

Ky vendim është përcillet dhe tek Ministria e Financave dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, lidhur me vlerën dhe zhvillimin e projektit, në veçanti me gjetjet e trajtuara në pikë15 të Vendimit, për arsye se çdo financim (buxhet) që do të jetë mbi zërat e përcaktuara në Marrëveshjen financiare duhet të përballohet nga Huamarrësi. Ministria e Financave si përfaqësuese e Qeverisë Shqiptare dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e ngarkuar si Agjencia Ekzekutive, duhet të marrin masa për sigurimin e fondit shtesë, i cili duhet të llogaritet nga DPUK/PIU Hidrik.

DPUK duhet të bëjë një analizë të hollësishme, me qëllim që të parashikoj sa më saktë shumën shtesë që do të duhet për të realizuar kontratën e punimeve dhe për të përfunduar me sukses projektin. Kjo analizë duhet të jetë sa më e studiuar me qëllim që të parashikojë të gjitha kostot shtesë të projektit.

Shënim: Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e auditimit janë konstatuar përgjegjësi për ish-drejtnes të DPUK-se dhe ish-koordinatorin e Njësisë së Zbatimit të Projektit z. K.B, të cilët kanë qenë të ngarkuar për zbatimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, për të cilët nuk rekomandojmë masa disiplinore duke i konsideruar të ezauruara, për arsye se nuk janë në marrëdhënie pune me DPUK, si dhe nuk kanë adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimit të tyre.

Ngarkohet DPUK të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për rezultatet e auditimit të KLSH për këto persona.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Yllka Pulashi, Ina Sokoli, Aldo Kume, Migena Nushi dhe Gentian Leva, më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Iliazi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj dhe Sekretari i Përgjithshëm Luljeta Nano.